

20221532067

Në bazë të nenit 25 paragrafi (1) dhe (3) dhe (47), paragrafi (1), pika 20) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

**VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË
NOMINALE 1000 DENARË**

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 1000 denarë me shenjë të shtypjes "јули 2022" (korrik 2022) dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetim, vlerën nominale dhe karakteristikave themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96), Vendimin për emetimin dhe shtypjen e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 500 dhe 1000 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/03), Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 500 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19) dhe Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 1000 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 49/21 dhe 83/22), duke filluar nga 1 shtatori 2022.

2. Me lëshimin në qarkullim të kartëmonedhave nga pika 1) e këtij vendimi, në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në qarkullim do të mbeten edhe kartëmonedhat me vlerë nominale 1000 denarë të emetuara në bazë të Vendimit për emetim, vlerë nominale dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96) dhe Vendimit për emetimin dhe shtypjen e kartëmonedhave me vlerë nominale prej 500 dhe 1000 denarë me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/03).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr.02-15/X-6/2022
30 qershor 2022
Shkup

Guvernatore
dhe kryesuese
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
dr. **Anita Angellovska-Bezhoska**, d.v.